

Termet e Referencës

Trajner/e për trajnim

HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

II. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për organizimin dhe fasilitimin e trajnimit “**Donor engagement and project proposals**” me anëtarët e stafit të HANDIKOS.

Objekti parësor i këtij trajnimi është pajisja e anëtarëve të stafit me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u angazhuar në mënyrë efektive me donatorët dhe për të zhvilluar projekt propozime. Trajnimi do të mbulojë tema të tilla si strategjitë e komunikimit të donatorëve, teknikat e shkrimit të projekt-propozimeve dhe praktikat më të mira për zbatimin dhe menaxhimin e projektit. Eksperti/ja duhet të ofrojë njohuri mbi praktikat më të mira për zhvillimin e projekt propozimeve të suksesshme që përputhen me kërkesat dhe prioritetet e donatorëve.

III. KUALIFIKIMI

Kandidati duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Përvojë në organizimin e trajnimeve lidhur me zhvillimin e projekt propozimeve;
- Njohuri të mira të qeverisjes së brendshme të OSHC-ve; menaxhimi i financave të OSHC-ve; zhvillimin e komunikimit, rrjetëzimit, mbledhjes së fondeve dhe politikave tjera relevante;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi.

IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Eksperti/ja duhet të zhvillojë modulën e trajnimit bazuar në kërkesat e HANDIKOS dhe të mbajë trajnimin siç është rënë dakord me ekipin e projektit të HANDIKOS;
- Eksperti/ja duhet të përpilojë një dokument “Vlerësimi” se si do të bëhet matja e suksesit të të nxëniet gjatë trajnimit;
- Të bashkëpunojë me ekipin e projektit për të vendosur objektivin, metodologjinë dhe përmbajtjen;
- Përgatit raportin e trajnimit duke përfshirë qëllimin, metodologjinë e përdorur, rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore;
- Eksperti/ja duhet që të bëjë edhe një “Donor Landscape Assessment” të HANDIKOS me qëllim që të identifikohen donatorët potencial dhe t’i njoftojë stafin/pjesëmarrësit gjatë trajnimit rreth këtij vlerësimi (vetëm kandidatit/es që përzgjidhet do t’i kërkohet kjo pikë).

V. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Maj 2024 në bazë ditore, ku do të përfshihet:

Detyra	Kohëzgjatja
Parapërgatitja e metodologjisë së trajnimit dhe materialeve	1 ditë
Zhvillimi i trajnimit	1 ditë
Finalizimi dhe dorëzimi i raportit të trajnimit tek HANDIKOS	1 ditë
Totali i ditëve	3 ditë

- Data tentative e punëtorisë: 24 Maj 2024 (bazuar në marrëveshje reciproke)
- Vendi: Prishtinë

VI. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe dorëzimit të raportit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologji e punës për këtë angazhim ose shembuj të angazhimeve të mëparshme të natyrës së ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për: **Ekspert/e për mbajtjen e trajnimit “Donor engagement and project proposals”**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 17/05/2024, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk është nën hetime;**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.